



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

RAPORT SPECIAL

TEMATIKA: Programet e transparencës, bashkite Tiranë, Kamëz, Vorë

(version i shkurtuar per web)

1. Hyrje

Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore i ka kushtuar një vëmëndje të posacme transparencës se bashkive me publikun. KREU VI i këtij ligji titullohet “**Transparenca, Konsultimi dhe Pjesëmarrja Qytetare**”. Nenet e këtij kreu, përvecse bëjnë përcaktime të qarta, referojnë në mëse një rast ligjin 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” si dhe ligjin Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Neni 15 i ligjit për vetëqeverisjen vendore titullohet “Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore”. Ai përcakton shprehimisht se :

- 1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.*
- 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.*
- 3. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatoren e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akes nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.*

Për të vlerësuar zbatimin e nenit 15 të ligjit 139/2015, është i domosdoshëm vlerësimi i programit të transparencës. **Program Transparenca** quhet dokumenti që përmbledh tërësinë e informacioneve që duhet të jepen në mënyrë aktive nga bashkia pa kërkesë¹. Sipas ligji 119/2014, autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit ose nga krijimi i tij, ka detyrimin ligjor të verë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni (neni 4/1). Në rastin e bashkive, ky program miratohet si fillim me vendim të këshillit bashkiak.

¹ <http://pyetshtetin.al/cfare-quhet-program-transparenca/>

Në përgatitjen e projekt-programit të transparencës, bashkia mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos: a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik; b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion; c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të ligjit 119/2014.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale (neni 6). Sipas udhëzimeve online², të bëra publike nga autoriteti mbikqyrës, programet e transparencës duhet të jenë krijuar në çdo bashki që pas datës 6 maj 2015 dhe duhet të jenë publikuar në faqet e tyre të internetit. Këto programe duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:

- a)** një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;
- b)** tekstat e plota të konventave të ratifikuara, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, të çdo dokumenti politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
- c)** informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- d)** të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- e)** të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- f)** mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- g)** të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.
- h)** informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjore në fushë, duke përfshirë: (i) listën e kontratave të lidhura; (ii) shumën e kontraktuar; (iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; (iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues të ndryshme;
- j)** informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet e shërbimit;
- k)** çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;
- l)** çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyrë tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
- m)** një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- n)** një kopje të përditësuar të Rregjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve;
- o)** një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;
- p)** informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;
- q)** çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik

² <http://pyetshtetin.al/cfare-quhet-program-transparence/>

2. Rezultatet e vlerësimit, Bashkia Tiranë, Kamëz, Vorë

Nga një vlerësim i brendisë së faqeve zyrtare të bashkive Tiranë, Kamëz dhe Vorë, (deri në datën 20 prill 2017), rezulton se të treja kanë një kategori të posaçme me emërtimin “Program Transparence” ose “Transparenca. Për programet e secilës bashki u ndërmor një vlerësim cilësor i informaciove që ai përmban. Për të lehtësuar procesin e pikëzimit, informacionet e kërkuar nga germat p) dhe q) nuk përfshihen në këtë vlerësim pasi përfaqësojnë vështirësi objektive në matje. Çdo germë tjetër është vlerësuar. Në metodologjinë e përdorur për këtë qellim, çdo germë (nga “a” në “o”) përfaqëson një indikator dhe pikëzohet në tre nivele:

I publikuar plotësisht	Pjesërisht i publikuar	Jo i publikuar
2 pikë	1 pikë	0 pikë

Programi i Transparencës i vlerësuar me këtë metodologji grumbullon 30 pikë të mundshme. Pikët kumulative (max 30) për programet e transparencës indeksohen duke u pjesëtuar me koeficientin 0.1. Ky koeficient synon të përputhë metodologjikisht vlerësimin sasior të prezantuar për Faqet, Koordinatorin, regjistrin e Pyetje-Përgjigjeve dhe Vendime me vlerësimin për Programin e Transparencës si një sistem kumulativ pikëzimi. Konkretisht, nëse një bashki grumbullon 25 pikë në total gjatë vlerësimit cilësor të programit të saj të transparencës, atëherë në vlerësimin e përgjithshëm, në kolonën për programet e transparencës, ajo do të rezultojë me 2.5 pikë, të cilat do të mbliidhen më pas me pikët e grumbulluar respektivisht për komponentet e tjere të vlerësimit: pajisjen me ëbsite, regjistri i pyetje përgjigjeve i perditesuar, caktimin e koordinatorit si dhe publikimin e vendimeve të këshillit bashkiak.

2.1. Vlerësimi i Programit të Transparencës, Bashkia Tiranë

Në tabelën e mëposhtme reflektohet vlerësimi cilësor i elementëve që përmban programi i transparencës së Bashkisë Tiranë. Për secilën nga kutizat e vlerësimit, në **Shtojca 1- Evidenca Metodologjike**, jepet në formatin print-screen, momenti i “fotografimit të faqes”. Vlen të theksohet se, elementët që më poshte janë të renditur në një tabelë të vetme, gjenden të shpërndara në të gjithë hapësirën (kategoritë) që përmban faqja zyrtare. Ato janë përmbledhur në tabelë nga INFOCIP, për të përkthyer me rigozitet mënyrën se si ato renditen në ligjin 119/2014, si dhe për të ofruar një mënyrë të thjeshtë (user-friendly) të leximit të rezultateve të këtij vlerësimi.

	Matrica e vlerësimit / pikë	2	1	0	
	Informacioni i programit të transparencës	Plotësisht i publikuar	Pjesërisht i publikuar	Jo i publikuar	Pikëzim
a.	Përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të A.P	✓			2
b.	Tekstet e plota të konventave, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, të cdo dokumenti politikash, të manualit ose ndonjë dokumenti tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të a. public...		✓		1

c.	Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit...	✓			2
d.	Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinorit për të DI	✓			2
e.	Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik ...	✓			2
f.	Mekanizmat monitorues e të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, dokumentet me tregues performances...	✓			2
g.	Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit...çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, dokumentet për gjendjen e shlyerjes së detyrimeve...	✓			2
h.	Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643/2006, dhe të ligjit nr. 125/2013, (PPP), që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese; përshkrimin e shërbimeve/ mallrave të kontraktuara; info për monitorim e kontratave...	✓			2
i.	Informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit	✓			2
j.	Cdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;	✓			2
k.	Cdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;	✓			2
l.	Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë	✓			2
m.	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve...	✓			1
n.	Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik , procedurave ...	✓			2
o.	Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	✓			2
TOTAL		29 PIKE			
TOTAL I PONDERUAR (koeficient 0.1)		2.9 PIKE			

2.2. Vlerësimi i Programit të Transparencës, Bashkia Kamëz

Bashkia Kamëz ka të publikuar gjithashtu në faqen e saj zyrtare Programin Transparencës. Një pjese e të dhënave që ky program duhet të përmbajë janë të shpëndara në tërësinë e faqes. Në tabelën e mëposhtme gjendet një vlerësim i të gjithë elementëve që përmban ky program, të ri-grupuara sipas renditjes në ligjin 119/2014 dhe udhëzimeve përkatëse.

	Matrica e vleresimi / pikë	2	1	0	x+y+z
	Programi i transparencës sipas gërmës	Plotësisht i publikuar	Pjesërisht i publikuar	Jo i publikuar	pikëzimi
a.	<i>Përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të A.P</i>	✓			2
b.	<i>Tekstet e plota të konventave, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, të çdo dokumenti politikash, të manualit ose ndonjë dokumenti tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të a. public...</i>	✓			2
c.	<i>Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit...</i>	✓			2
d.	<i>Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të DI</i>	✓			2
e.	<i>Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, përshkrim të detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik ...</i>		✓		1
f.	<i>Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet me tregues performancës së autoritetit</i>	✓			2
g.	<i>Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, dokumentet për gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet</i>	✓			2
h.	<i>Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643/2006, dhe të ligjit nr. 125/2013, (PPP), që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e</i>			✓	0

	<i>kontratave; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese: përshkrimin e shërbimeve/ mallrave të kontraktuara; info për monitorim e kontratave...</i>				
i.	<i>Informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit</i>	✓			2
j.	<i>Cdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;</i>	✓			2
k.	<i>Cdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP;</i>	✓			2
l.	<i>Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë</i>	✓			2
m.	<i>Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve...</i>	✓			2
n.	<i>Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik, procedurave ...</i>	✓			2
o.	<i>Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.</i>	✓			2
	TOTAL	27 PIKE			
	TOTAL I PONDERUAR (koeficient 0.1)	2.7 PIKE			

2.3. Vlerësimi i Programit të Transparencës në Bashkinë Vorë

Bashkia Vorë ka publikuar në faqen zyrtare Programin e saj të Transparencës. Në tabelën e mëposhtme gjendet një vlerësim i të gjithë elementëve që duhet të përmbajë programi i transparencës. Bashkia Vorë nuk e ka të publikuar si nje kategori qendrore në faqen e parë të ëebisit-it zyrtar programin e transparencës. Ai gjendet i nën-renditur në kategorinë **“Shërbime”**. Në tabelën e mëposhtme reflektohet vlerësimi cilësor i elementëve që përmban programi i transparencës së Bashkisë Tiranë. Për secilën nga kutizat e vlerësimit, në Shtojca 1- Evidenca Metodologjike, jepet në formatin print-screen, (momenti i “fotografimit të faqes”, shih shtojca 1, evidenca Metodologjike).

	<i>Matrica e vleresimi / pikë</i>	2	1	0	$x+y+z$
	Informacioni i programit të transparencës	Plotësisht i publikuar	Pjesërisht i	Jo i publikua	Pikëzim

			publikuar	r	
a.	<i>Përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të A.P</i>	✓			2
b.	<i>Tekstet e plota të konventave, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, të çdo dokumenti politikash, të manualit ose ndonjë dokumenti tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të a. public...</i>	✓			2
c.	<i>Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit...</i>	✓			2
d.	<i>Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të DI</i>	✓			2
e.	<i>Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik ...</i>		✓		1
f.	<i>Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet me tregues performancës së autoritetit</i>	✓			2
g.	<i>Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifatat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, dokumentet për gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet</i>	✓			2
h.	<i>Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643/2006, dhe të ligjit nr. 125/2013, (PPP), që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese: përshkrimin e shërbimeve/mallrave të kontraktuara; info për monitorim e kontratave...</i>			✓	0
i.	<i>Informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit</i>	✓			2
j.	<i>Cdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;</i>	✓			2
k.	<i>Cdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;</i>	✓			2

<i>l.</i>	<i>Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë</i>	✓			2
<i>m.</i>	<i>Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve...</i>	✓			2
<i>n.</i>	<i>Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik , procedurave ...</i>	✓			2
<i>o.</i>	<i>Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.</i>	✓			2
	TOTAL	27 PIKE			
	TOTAL I PONDERUAR (koeficient 0.1)	2.7 PIKE			